



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

Nr. \_\_\_\_\_ Prot.

Tiranë, më \_\_\_\_\_.\_\_\_\_.2021

EKSTRAKT

**V E N D I M**

**Nr. 92, datë 17.03.2021**

**PËR**

**CAKTIMIN E MASËS DISIPLINORE NDAJ GJYQTARES {...}**

Këshilli i Lartë Gjyqësor, bazuar në nenet 140, pika 2, shkronja “a”, 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 146, pika 2, shkronja “b” dhe 157, të Ligjit nr.96/2016, “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, nenet 86, shkronja “e” dhe 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe nenin 104, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë, mori në shqyrtim kërkesën për procedim disiplinor nr. 03/2020, që iu përket:

**KËRKUES:**

**Inspektori i Lartë i Drejtësisë, z.Artur Metani.**

**SUBJEKT I PROCEDIMIT:**

**Znj. {...} , me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} , e përfaqësuar nga Av. {...} i Dhomës së Avokatisë Tiranë.**

**OBJEKTI I KËRKESËS:**

- 1. Fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjstrates **Znj.{...}** , me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor Krujë.**
- 2. Propozimin për caktimin e masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.**

**BAZA LIGJORE:**

Neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 102, pika 1, shkronja “ç” dhe “dh”, neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “c”, neni 105, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 111, pika 1 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar.

Këshilli i Lartë Gjyqësor, pasi shqyrtoi çështjen në tërësi, në seancë dëgjimore në përputhje me parashikimet e neneve 142 e vijues të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe dëgjoi:

- **Inspektorin e Lartë të Drejtësisë Z.Artur Metani**, i cili përfundimisht kërkoi pranimin e kërkesës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...} , me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...} , për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nga neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “dh” dhe neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “c” e Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, dhe caktimin ndaj saj të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”.
- **Magjistraten Znj. {...} dhe përfaqësuesin e saj Av. {...}** , të cilët kërkuan rrëzimin e kërkesës së paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në përfundim të procedimit disiplinor;

## V Ë R E N:

### I. Rrethanat:

1. Pranë Këshillit të Lartë Gjyqësor (në vijim Këshilli), në datë 10.12.2020, me nr. 5799/3 Prot., është depozituar kërkesa e Inspektorit të Lartë të Drejtësisë (në vijim referuar si ILD) për fillimin e procedimit disiplinor ndaj magjistrates {...} , me detyrë gjyqtare në Gjykatën e Rrethit Gjyqësor {...}

2. Kërkesa për fillimin e procedimit disiplinor mbështetet në nenin 194 të ligjit nr. 115/2016 “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, dhe nenin 138 të ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, (në vijim referuar si Ligji “Për Statusin”) për shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 140, pika 2, shkronja ”a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe neni 102, pika 1, shkronjat “ç” dhe “dh” si dhe nga neni 102, pika 2, shkronjat “a” dhe “c” të Ligjit “Për Statusin”.

2.1 Në kërkesën për fillimin e procedimit disiplinor, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka paraqitur propozimin për caktimin ndaj magjistrates {...} , të masës disiplinore “Shkarkim nga detyra”, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja ”a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, neni 105, pika 1, shkronja “dh” dhe neni 111, pika 1 e Ligjit “Për Statusin”.

3. Nga dosja hetimore e depozituar pranë Këshillit, rezulton se me vendimin Nr. 1751 prot., datë 16.07.2020, Inspektori i Lartë i Drejtësisë ka vendosur fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjistrates {...} , me detyrë gjyqtare pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor {...} , për shkelje të rënda profesionale, që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarit gjatë ushtrimit të detyrës, të parashikuar nga neni 140, pika 2, shkronja “a” e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe

shkeljet disiplinore të parashikuara nga neni 102, pika 1, shkronja “ç”, shkronja “dh”, dhe neni 102, pika 2, shkronja “a” dhe shkronja “c” të Ligjit “Për Statusin”.

4. Në vijim të procedurës hetimore, Inspektori i Lartë i Drejtësisë me vendimin Nr. 1751/10, datë 20.11.2020, ka vendosur bashkimin e procedimeve disiplinore, për shkelje të përcjella nga Ministria së Drejtësisë, me shkresën Nr. 3826/1 prot., datë 23.07.2020, që kishin lidhje me njëjtat fakte dhe pretendime, të analizuara në vendimin për fillimin e hetimit disiplinor.

5. Objekt i hetimit disiplinor kanë qenë fakte, të cilat kanë ndodhur brenda afatit të parashkrimit për hetimin disiplinor, referuar nenit 117, të Ligjit “Për Statusin”, dhe që kanë justifikuar fillimin e hetimit disiplinor me iniciativë ndaj magjstrates {...} , për faktet e konstatuara gjatë gjykimit të kërkesave që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit penal për të dënuarit {...} dhe {...} .

6. Bazuar në aktet e dosjes hetimore dhe aktet e administruara në përfundim të procedimit disiplinor të zhvilluar në Këshill, rezultoi e provuar se, me vendimin nr. 01, datë 28.01.2010 të Gjykatës {...} , ndryshuar me vendimin nr. 23, datë 06.04.2010 të Gjykatës {...} <sup>1</sup>, është vendosur deklarimi fajtor i të dënuarit I.P, për kryerjen e veprës penale të “*Plagosjes së rëndë me dashje*”, e parashikuar nga neni 88/1 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 8 vjet burgim, si dhe deklarimi fajtor për kryerjen e veprës penale të “*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit*”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 2 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, i dënuari {...} është dënuar me 10 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, është dënuar me 6 vjet e 8 muaj burgim.

6.1 Në vijim, me vendimin nr. 51, datë 10.10.2011 të Gjykatës {...} , është vendosur deklarimi fajtor i të dënuarit {...} për kryerjen e veprës penale të “*Vrasjes në rrethana të tjera cilësuese*”, e kryer në bashkëpunim, e parashikuar nga neni 79/dh dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 20 vjet burgim, deklarimi fajtor për kryerjen e veprës penale të “*Rrëmbimit ose mbajtjes peng të personit*”, të kryer në bashkëpunim, të parashikuar nga neni 109/1 dhe 25 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 12 vjet burgim, deklarimi fajtor për kryerjen e veprës penale të “*Marrëdhënies seksuale me dhunë me të rritura*”, e parashikuar nga neni 102/1 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 4 vjet burgim dhe deklarimi fajtor për kryerjen e veprës penale të “*Prodhimit dhe mbajtjes pa leje të armëve luftarake dhe municionit*”, të parashikuar nga neni 278/2 i Kodit Penal dhe dënimi i tij me 3 vjet burgim. Në zbatim të nenit 55 të Kodit Penal, i pandehuri {...} është dënuar me 23 vjet burgim dhe në aplikim të nenit 406/1 të Kodit të Procedurës Penale, është dënuar me 15 vjet e 4 muaj burgim.

6.2 Në përfundim të gjykimit të çështjeve penale në ngarkim të të dënuarit {...} , si më lart cituar, me vendimin nr. 58, datë 04.10.2012 të Gjykatës {...} <sup>2</sup>, për bsa i përket dënimeve me

---

<sup>1</sup>Vendimi është lënë në fuqi me vendimin nr. 212, datë 16.07.2012 të Gjykatës së Lartë.

<sup>2</sup>Vendimi ka marrë formë të prerë në datë 15.10.2012.

burgim<sup>3</sup>, është vendosur bashkimi i dënimeve në një dënim të vetëm prej 17 vite burgim, duke përcaktuar si datë të llogaritjes së dënimit datën 06.03.2008.

6.3 Më datë 07.10.2016, i dënuari {...} ka paraqitur kërkesën penale nr.54, me objekt “*Lirim nga burgu për arsye të rënda shëndetësore*”<sup>4</sup>, parashikuar nga neni 478 të Kodit të Procedurës Penale<sup>5</sup>, e cila i ka kaluar për gjykim gjyqtarës {...} . Me vendimin e ndërmjetëm të datës 01.12.2016, mbi kërkesën e palës kërkuese, gjyqtarja e çështjes ka marrë vendim për caktimin e një grupi ekspertësh nga Instituti {...} . Në vijim të gjykimit, është paraqitur kërkesa e të dënuarit për përjashtim të gjyqtarës nga gjykimi i çështjes, kërkesë e cila është rrëzuar me vendimin nr. 17, datë 23.01.2017. Në seancën e datës 08.02.2017, i dënuari ka paraqitur kërkesë për heqje dorë nga gjykimi, mbi bazën e të cilës gjyqtarja {...} ., ka disponuar me vendimin nr. 8/54 akti, datë 08.02.2017, për rrëzimin e kërkesës.

6.4 Më datë 17.07.2017 i dënuari {...} ka paraqitur kërkesën penale me objekt “*Aplikim dënimi alternativ, qëndrim në shtëpi*”, bazuar në nenin 59/a e vijues të Kodit Penal, regjistruar me nr.63 akti, e cila i ka kaluar për gjykim gjyqtarës {...} . Ndërkohë, pas 8 ditësh, në datë 25.07.2017, i dënuari I.P, ka paraqitur kërkesën penale, me emër të ndryshuar dhe me objekt: “*Qëndrim në shtëpi*”, bazuar në nenin 59/a, germa c) të Kodit Penal. Kërkesa është regjistruar me nr. 65 akti, e cila pas shortit elektronik<sup>6</sup>, i ka kaluar për shqyrtim magjstrates {...} .

6.5 Në kërkesën penale të regjistruar më parë, pranë gjyqtarës {...} ., i dënuari ka paraqitur kërkesë për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes. Në këto kushte gjyqtarja, me vendimin nr. 63, datë 07.09.2017<sup>7</sup>, ka vendosur mospranimin e kërkesës penale. Në këtë mënyrë nga i dënuari I.P është përzgjedhur vijimi i shqyrtimit të kërkesës penale me nr. 65 akti, me të njëjtin objekt, pranë gjyqtarës {...} . Në lidhje me shqyrtimin e saj, nga kjo e fundit më datë 06.11.2017, është vendosur:

*Pranimin e kërkesës. Aplikimin e dënimit alternativ “Qëndrim në shtëpi” për kërkuesin I.P, për pjesën e mbetur të dënimit prej 1 vit 8 muaj dhe 9 ditë burgim, duke e vënë në provë për një periudhë kohore prej 1 vit dhe 8 muaj. Të lejohet kërkuesi {...} që të largohet nga banesa e tij për plotësimin e nevojave të domosdoshme e konkretisht të trajtimeve dhe shërbimeve shëndetësore kjo referuar dhe raportit të vlerësimit datë 12.10.2017 të Shërbimit të Provës. Urdhërohet i dënuari {...} që gjatë kohës së qëndrimit në shtëpi t'i raportojë rregullisht Shërbimit të Provës. Urdhërohet lirimi i menjëhershëm i të dënuarit I.P nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale. Urdhërohet Prokuroria e Rrethit Gjyqësor {...} për ekzekutimin e këtij vendimi.....*

6.5.1 Nga përmbajtja e vendimit dhe e dosjes gjyqësore, rezulton se në dhënien e këtij vendimi, janë administruar: (i) dosja e të dënuarit I.P; (ii) kartela klinike e tij; (iii) dokumentacioni

<sup>3</sup>Në vendimin nr.51, datë 10.10.2011 të Gjykatës {...} është disponuar për dënimin e të dënuarit {...} dhe me dënimin me gjobë, krahas atij me burgim.

<sup>4</sup>Pretendimi është për sëmundjen “endogjen bipolar, me tentative suidale”.

<sup>5</sup>Dispozitë e pa shfuqizuar në kohën e paraqitjes së kërkesës nga ana e të dënuarit {...} .

<sup>6</sup>Emri i kërkuesit është pasqyruar {...} .

<sup>7</sup>Vendimi ka marrë formë të prerë në datë 22.09.2017, pasi nuk është ushtruar e drejta e ankimit nga palët

mjekësor i lëshuar nga mjekët pranë Spitalit {...} : {...} dhe {...} ; (iv) është pyetur në cilësinë e dëshmitarit, përgjegjësi i shërbimit shëndetësor të I.E.V.P-së; (v) raporti i vlerësimit për të dënuarin, paraqitur nga Shërbimi i Provës; (vi) Informacion shëndetësor për të dënuarin I.P datë 02.11.2017.

6.5.2 Sipas shkresës “Dinamika e vuajtjes së dënimit”, datë 02.11.2017, të paraqitur nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale {...} , rezulton se nga i dënuari {...} është vuajtur 15 vite, 3 muaj dhe 17 ditë burgim<sup>8</sup> dhe i kanë mbetur pa vuajtur 1 vit, 8 muaj dhe 13 ditë burgim. Në periudhën e vuajtur, krahas dënimit të vuajtur fizikisht, janë përlllogaritur 2 vite, 6 muaj dhe 29 ditë nga koha e paraburgimit, 1 vit dhe 7 muaj e 5 ditë, i janë ulur me vendime gjyqësore<sup>9</sup>, 5 muaj e 17 ditë nga aktivizimi në punë, dhe 1 vit nga zbatimi i ligjit nr.22/2014 “Për amnistinë”.

6.5.3 Konstatohet se gjatë gjykimit nga magjistratja nuk është vendosur kryerja e ndonjë akti ekspertimi mjeko-ligjor për të provuar pretendimet e palës kërkuese. Një kërkesë e tillë procedurale nuk është bërë as nga palët, por as nuk është vlerësuar marrja e saj, kryesisht, nga gjykata.

7. Në lidhje me gjykimin e kërkesave që lidhen me fazën e ekzekutimit të vendimit penal për të dënuarin {...} , bazuar në aktet e dosjes hetimore dhe akteve të administruara në përfundim të procedimit disiplinor të zhvilluar në Këshill, rezultoi e provuar se, me vendimin nr. 23 akti, datë 13.05.2014 të Gjykatës {...} <sup>10</sup>, është vendosur:

*“Njohja e vendimit penal të huaj nr. T20087287, datë 14.10.2008 të Gjykatës {...} , dhënë ndaj shtetasit shqiptar {...}, i datëlindjes 14.09.1980. lindur në {...} dhe banues në {...} , i dënuar për veprat penale “Vrasje”, “Vrasje mbetur në tentativë dy herë”, si dhe “Plagosje me dashje për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor”, vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale “Vrasje në rrethana cilësuese” parashikuar nga neni 79/dh i Kodit Penal. Caktimin e dënimit me burgim të përjetshëm për shtetasin shqiptar {...} . Vuajtja e dënimit për të dënuarin të fillojë më datë 15.11.2007.....*

7.1 Më datë 26.01.2016, i dënuari {...} është marrë në dorëzim nga autoritetet angleze<sup>11</sup> dhe rezulton të jetë transferuar në I.E.V.P {...} më datë 27.01.2016. Mbi kërkesën e tij, me vendimin nr.382, datë 22.04.2016 të Gjykatës {...} , është vendosur rivendosja në afat për të ushtruar ankim ndaj vendimit nr.23, datë 13.05.2014 të Gjykatës {...} . Në vijim, Gjykata {...} , me vendimin nr.1016, datë 20.07.2016<sup>12</sup>, ka vendosur:

<sup>8</sup>Nga dënimi i dhënë ka vuajtur fizikisht 9 vite 7 muaj dhe 26 ditë.

<sup>9</sup>Vendimet e Gjykatës {...} : vendimi nr. 236, datë 06.05.2011, vendimi nr.228, datë 26.06.2012 (dhënë nga magjistratja {...} ), vendimi nr.340, datë 24.07.2013, vendimi nr. 379, datë 25.09.2014, vendimi nr. 348, datë 28.12.2016 (dhënë nga magjistratja {...} ), vendimi nr.188, datë 17.07.2017.

<sup>10</sup> Gjykata {...} me vendimin nr. 1239, datë 29.06.2015, ka vendosur mospranim e ankimit të paraqitur, për shkak se është bërë nga persona të pa legjitimuar. Gjykata {...} me vendimin nr. 119, datë 28.01.2016 ka vendosur mospranimin e rekursit.

<sup>11</sup>Referuar shkresës nr. 68/1 prot., datë 22.01.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

<sup>12</sup> Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe çështja me nr.59403-01652-00-2016, datë 16.09.2016, ndodhet për shqyrtim në Gjykatën {...} , ndërsa ende nuk ka dalë me vendim mbi këtë çështje.

*“Ndryshimin e vendimit nr. 23, akti datë 13.05.2014 të Gjykatës {...} , si vijon: Pranimin e kërkesës. Njohjen e vendimit penal të huaj nr. T20087287, datë 14.10.2008 të Gjykatës {...} , dhënë ndaj shtetasit shqiptar {...} , i dënuar për veprat penale: vrasje, vrasje mbetur në tentativë dy herë, plagosje me dashje për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor, vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale të “Vrasjes”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe caktimin e dënimit me 20 vite burgim, për veprën penale të “Vrasjes së mbetur në tentativë” dhe në bazë të nenit 76 dhe 23 të Kodit Penal caktimin e dënimit me 15 vite burgim, për veprën penale të “Plagosje e rëndë me dashje” dhe në bazë të nenit 88/1 të Kodit Penal dënimin e tij me 10 vite burgim. Në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit {...} me 25 vite burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data 15.11.2007.....*

7.2 Me urdhrin e ekzekutimit të vendimit penal të Prokurorisë {...}, datë 07.09.2016 është përcaktuar se nga data e arrestimit në {...} datë 15.11.2007 deri në ekstradimin e tij në Shqipëri, datë 26.01.2016, i dënuari ka vuajtur 8 vjet, 7 muaj dhe 27 ditë burgim, duke i mbetur për të vuajtur në Shqipëri 16 vjet, 4 muaj dhe 3 ditë burgim, nga data 26.01.2016 e në vazhdim. Në vijim, me vendimin nr. 278 akti, datë 10.10.2016 të Gjykatës {...} është vendosur caktimi i llojit të sigurisë së burgut për të dënuarin {...} në atë të sigurisë së zakonshme.

7.3 Pas rreth 7 muaj nga dhënia e vendimit nr.1016, datë 20.07.2016 nga Gjykata {...} , i dënuari {...} ka paraqitur një kërkesë më objekt ulje dënimi, regjistruar me nr.44 akti, datë 01.02.2017, e cila ka kaluar për shqyrtim tek gjyqtarja {...} . Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr.44 akti, datë 13.03.2017<sup>13</sup>, është vendosur rrëzimi i kërkesës me arsyetimin se ajo është paraqitur pa kaluar afati 1 vjeçar, nga marrja formë të prerë e vendimit të njohjes së dënimit me nr. 1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës {...}

7.3.1 Menjëherë pas shpalljes së vendimit nr. 44 akti, po në datë 13.03.2017, i dënuari {...} ka depozituar në gjykatë, një tjetër kërkesë penale me objekt:

*“Ulje dënimi në masën 90 ditë për çdo vit kalendarik të vuajtjes së dënimit nga momenti i dënimit të tij në datë 14.10.2008 nga Gjykata {...} njohur me vendimin nr.23, datë 13.05.2014 të Gjykatës {...}.”*

7.3.2 Kjo kërkesë penale ka kaluar për shqyrtim magjistrates {...} . Me shkresën nr.24/1 Prot., datë 24.04.2017, magjistratja, gjatë shqyrtimit gjyqësor është njoftuar nga Kancelari i Gjykatës<sup>14</sup> se, pranë Gjykatës {...} është shqyrtuar nga gjyqtarja {...} , kërkesa me objekt ulje dënimi që i përket kërkuarit {...} . Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor, me vendimin nr.85 akti, datë 25.05.2017<sup>15</sup>, magjistratja ka vendosur:

*“Pranimi i kërkesës të të dënuarit {...} . Uljen e dënimit në masën 24 muaj për periudhën nga data 14.10.2008- 25.05.2017.....*

7.3.3 Në vendimin e saj, magjistratja arsyeton se, Komisioni i Vlerësimit, pranë Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale {...} ishte shprehur për pranimin e kërkesës dhe se kërkuari

<sup>13</sup> Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar më datë 23.02.2017.

<sup>14</sup> Informacioni sipas shkresës, i është vendosur në dispozicion magjistrates mbi kërkesën e saj datë 04.04.2017, bashkë me një kopje të vendimit.

<sup>15</sup>Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar më datë 06.06.2017.

kishte marrëdhënie shumë të mira me bashkë vuajtësit dhe aktivizohej në veprimtaritë me natyrë edukative, kulturore dhe sportive. Gjithashtu, ajo argumenton se nga pala kërkuese kishte paraqitur akte dhe certifikata të marra gjatë vuajtjes së dënimit në shtetin anglez, ku dokumentohej pjesëmarrja e tij në kurse profesionale dhe arsimore, duke pasqyruar për shfaqjen e tij për t'u ri integruar në komunitet dhe shoqëri. Në këto kushte, bazuar në ligjin nr.8499, datë 10.06.1999 “Për ratifikimin e Konventës së këshillit të Evropës për transferimin e personave të dënuar”, ku parashikohet se “I dënuari përfiton nga te gjitha lehtësirat që ofron legjislacioni i shtetit zbatues, si dhe duket përfituar statusin e të dënuarit” si dhe nenit 63 të ligjit nr.8328, të vitit 2009 “Për të drejtat dhe trajtimin e personave të dënuar”, magjistratja arrin në përfundimin se kërkesa e të dënuarit {...} duhej pranuar, duke ulur masën e dënimit për të dënuarin {...}, për një periudhë totale prej 24 muaj, që përkon nga data e dënimit të tij nga Gjykata {...}, deri në datën e dhënies së vendimit nr. 85 Akti, datë 25.05.2017.

7.4 I dënuari {...}, pas marrjes formë të prerë të vendimit nr. 85 akti, datë 25.05.2017, ka vijuar betejën e tij ligjore, duke paraqitur: në datë 14.07.2017, kërkesën e regjistruar me nr.192 akti me objekt “Njohje të kohës së paraburgimit”<sup>16</sup>, në datë 20.09.2017, kërkesën me objekt “Përfitim nga amnistia”, në bazë të ligjit nr.22/2014, e regjistruar me nr.217 akti dhe kërkesën datë 11.10.2017 me objekt “Llogaritje dënimi” e regjistruar me nr.7/2075 akti. Në dy nga këto çështje është vendosur mospranimi apo rrëzimi i kërkesës për shkak të heqjes dorë nga kërkesa dhe në një vendim çështja është shqyrtuar në themelin e saj.

7.5 Në datë 10.01.2018, i dënuari {...} ka paraqitur kërkesën tjetër të radhës me objekt “Njohje e kohës së paraburgimit”. Çështja ka kaluar për shqyrtim tek magjistratja {...}, e cila me vendimin nr.82 akti, datë 14.02.2018<sup>17</sup>, ka vendosur:

*“Pranimin e kërkesës të të dënuarit {...}. Njohjen e ditëve të paraburgimit të të dënuarit nga data e arrestimit të tij nga autoritetet angleze datë 15.11.2007 deri kur vendimi i gjykatës së Apelit {...} ka marrë formë të prerë më datë 20.07.2016.....*

7.5.1 Në vendim magjistratja argumenton se koha e paraburgimit nga data e ndalimit të kërkuarit nga autoritetet angleze, datë 15.11.2007, deri në marrjen formë të prerë të vendimit, datë 20.07.2016, nuk janë pasqyruar në dinamikën e vuajtjes së dënimit, megjithëse ai kishte cilësinë e të paraburgosurit. Magjistratja ka referuar në mënyrë të përgjithshme në “Konventën Europiane për vlefshmërinë ndërkombëtare të gjyqimeve penale”, të ratifikuar me ligjin nr.9068, datë 15.05.2003 dhe “Marrëveshjen ndërmjet Republikës së Shqipërisë dhe Mbretërisë së Bashkuar të Britanisë së Madhe e Irlandës së Veriut për transferimin e personave të dënuar”, ratifikuar me ligjin nr. 98/2013, ku sipas saj është parashikuar se mënyra e llogaritjes së vuajtjes së dënimit bëhet në bazë të ligjeve dhe procedurave të shtetit marrës, që në rastin konkret, ishte shteti shqiptar.

---

<sup>16</sup> Çështja ka kaluar për shqyrtim tek gjyqtarja {...}, e cila me vendimin nr. 192, datë 27.12.2017 ka vendosur shpalljen e papranueshme të kërkesës, për shkak të heqjes dorë.

<sup>17</sup> Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datë 01.03.2018.

7.5.2 Në mbështetje të vendimmarrjes së saj magjistratja citon edhe vendimin unifikues nr.02, datë 03.11.2014 të Gjykatës {...} , sipas të cilit me vendim penal të formës së prerë do të kuptohet vendimi i ekzekutueshëm i Gjykata {...} . Po kështu, ajo argumenton se me vendimin nr. 217, date 06.11.2017, Gjykata {...} ka rrëzuar një nga kërkesat e kërkuetit {...} me arsyetimin se kërkueti {...} ka fituar cilësinë e të dënuarit me vendimin nr.1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës {...} .

7.5.3 Bazuar në këto argumente, magjistratja {...} ka arritur në përfundimin se kërkesa është e mbështetur në prova dhe në ligj duke vendosur pranimin e saj.

7.6 Në mënyrë kronologjike, për periudhën 02.02.2018-04.06.2018, i dënuari {...} ka vijuar me paraqitjen e kërkesave të tjera penale, gjatë fazës së ekzekutimit të vendimit, gjithsej 6 të tilla. Konkretisht kërkesat janë të regjistruara në datë 02.02.2018, regjistruar me nr.133 akti<sup>18</sup>, në datë 07.02.2018, regjistruar me nr.145 akti<sup>19</sup>, në datë 28.04.2018, regjistruar me nr.281 akti<sup>20</sup>, Në datë 07.05.2018, regjistruar me nr.302 akti<sup>21</sup>, në datë 16.05.2018, regjistruar me nr.326 akti<sup>22</sup> dhe në datë 04.06.2018, regjistruar me nr.52 akti<sup>23</sup>, përkatësisht me objektet “Llogaritje e ditëve të paraburgimit”, “Ulje dënimi” dhe “Njohje e kohës së paraburgimit”, “Njohjen e ditëve të punës të kryera pranë institucionit të vuajtjes së dënimit në Angli”, “Ulje dënimi në masën 90 ditë” dhe “Lirim para kohe me kusht”.

7.7 Në datë 04.07.2018 nga kërkueti {...} është paraqitur kërkesa me objekt “Njohje amnistie”. Çështja ka kaluar magjistrates {...} , e cila me vendimin nr.463, datë 21.11.2018<sup>24</sup> ka vendosur:

*“Pranimin e kërkesës së kërkuetit {...} . Njohjen e amnistisë për kërkuetin {...} , duke i ulur 1 vit nga dënimi, sipas ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”.....*

7.7.1 Në këtë vendim magjistratja arsyeton se për efekt të njohjes së vendimit penal të huaj dhe zbatimit të legjislacionit penal shqiptar, i dënuari {...} ka marrë atributet dhe cilësinë e të dënuarit me vendimin nr.1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës {...} dhe si i tillë ka kërkuar të përfitojë nga ligji nr.141/2016 “Për amnistinë”, sipas neneve 4 dhe 5 të këtij ligji. Pasi ka

---

<sup>18</sup> kaluar për shqyrtim gjyqtares {...} , e cila me vendimin nr. 133 akti, datë 01.03.2018 ka vendosur pushimin e gjykimit për shkak të heqjes dorë të kërkuetit {...} . Në këtë kërkesë është pretenduar njohja e ditëve të paraburgimit në Danimarkë pasi ka qëndruar në paraburgim për ekstradim për të njëjtën çështje që po vuan dënimin.

<sup>19</sup> kaluar për shqyrtim gjyqtares {...} , e cila me vendimin nr. 145 akti, datë 22.02.2018 ka vendosur deklarimin e papranueshëm për shkak të heqjes dorë të kërkuetit {...} .

<sup>20</sup> kaluar për shqyrtim gjyqtares {...} , e cila me vendimin nr.281 akti datë 03.05.2018, ka vendosur pranimin e kërkesës dhe njohjen e kohës së paraburgimit nga data e arrestimit të autoriteteve daneze 04.09.2007 deri në transferimin e tij në shtetin anglez 14.11.2007.

<sup>21</sup> kaluar për shqyrtim gjyqtares {...} , e cila me vendimin nr. 302, datë 02.07.2018 ka vendosur rrëzimin e kërkesës me arsyetimin se vendimet e huaja pas njohjes së tyre ekzekutohen sipas legjislacionit shqiptar dhe nuk parashikohet konvertimi në ulje dënimi i punës së kryer në shtetin e huaj. Së dyti, argumenton se llogaritja e ditëve të punës në uljen e dënimit bëhet nga IEVP ku i dënuari vuan dënimin.

<sup>22</sup> kaluar për shqyrtim gjyqtares {...} , e cila me vendimin nr. 326, datë 07.06.2018 ka vendosur pranimin e kërkesës duke ulur dënimin në masën e 90 ditëve

<sup>23</sup> kaluar për shqyrtim gjyqtares {...} , e cila me vendimin nr. 52akti, datë 27.06.2018, është vendosur mospranimi i kërkesës penale për shkak të heqjes dorë

<sup>24</sup> Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datë 06.12.2018.



analizuar dispozitën ligjore, aktet e sjella nga I EVP { ... } , me shkresën datë 23.07.2018, mbështetur në ligjin nr.141/2016 “Për amnistinë”, nenet 4 dhe 5 të tij, magjistratja ka çmuar se kërkesa e kërkuarit { ... } është e mbështetur në prova dhe në ligj dhe si e tillë ajo duhet të pranohet, duke i ulur atij një vit burgim.

7.8 Ndërkohë që nga ana e magjistrates { ... } po shqyrtohej kërkesa e datës 04.07.2018 me objekt “Njohje amnistie”, në datë 01.10.2018, i dënuari { ... } ka paraqitur një kërkesë tjetër penale me objekt “Lirim me kusht”, bazuar në nenin 64 të Kodit Penal. Çështja i ka kaluar për shqyrtim tek gjyqtarja E.T. Në datë 03.10.2018 nga kërkuari është paraqitur kërkesë për përjashtimin e gjyqtares nga gjykimi i çështjes, e cila i ka kaluar për shqyrtim gjyqtares { ... } . Kjo e fundit, me vendimin nr.580, datë 05.10.2018 ka vendosur pranimin e kërkesës me arsyetimin se, kërkesa është e drejtë në kushtet kur nga ana e kësaj gjyqtareje është vendosur rrëzimi i dy kërkesave të të dënuarit { ... } gjatë fazës së ekzekutimit të dënimit, kërkesa për të cilat në një rast prokurori ka qenë dakord dhe tjetrën ai e ka lënë në çmim të Gjykatës. Pas përjashtimit, çështja ka kaluar tek gjyqtarja { ... } , e cila me vendimin nr. 81, datë 25.10.2018<sup>25</sup> ka vendosur shpalljen e papranueshme të kërkesës për shkak të heqjes dorë të kërkuarit.

7.9 Në datë 07.01.2019 nga i dënuari { ... } është paraqitur kërkesa me objekt “Lirim me kusht”. Çështja ka kaluar për shqyrtim gjyqtares { ... } . Në datë 08.01.2019, nga i dënuari { ... } është paraqitur një kërkesë tjetër penale me objekt “Ulje dënimi në masën 90 ditë”. Edhe kjo çështje i ka kaluar për shqyrtim magjistrates { ... } . Pra, në të njëjtën kohë magjistratja ka pasur në shqyrtim dy kërkesa penale me kërkuar të dënuarin { ... } .

7.9.1 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës me objekt “Ulje dënimi në masën 90 ditë”, magjistratja me vendimin nr.81, datë 18.01.2019<sup>26</sup> ka vendosur:

*“Pranimin e kërkesës së kërkuarit { ... } . Uljen e dënimit për kërkuarin { ... } në masën 90 ditë për periudhën kohore, vitin 2007.....*

Në pjesën arsyetuese gjyqtarja ka konstatuar se me vendimin nr.281 akti, datë 03.05.2018 të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor { ... } , gjykata ka njohur kohën e paraburgimit për kërkuarin { ... } për vitin 2007.

7.9.2 Në përfundim të shqyrtimit gjyqësor të kërkesës me objekt “Lirim me kusht”, me vendimin nr.26 akti, datë 22.02.2019<sup>27</sup>, është vendosur:

*“Pranimin e kërkesës së kërkuarit (të dënuarit) { ... } . Lirimin me kusht të kërkuarit (të dënuarit) { ... } për dënimin e mbetur të pavuajtur prej 5 vjet, 2 muaj dhe 11 ditë, për një kohë prove prej 5 vjetësh. Në zbatim të nenit 60 pika 1 e Kodit Penal i dënuari { ... } të ushtrojë një veprimtari profesionale referuar kontratës së punës pranë personit fizik { ... } dhe referuar nenit 60 pika 9 e Kodit Penal, i dënuari { ... } përgjatë kohës së provës të*

<sup>25</sup> Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datë 09.11.2018.

<sup>26</sup>Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datë 04.02.2019.

<sup>27</sup> Vendimi ka marrë formë të prerë pa u ankimuar në datë 11.03.2019.

*mos shoqërohet me persona të caktuar, kryesisht me të dënuar. Urdhërohet i dënuari {...} të mbajë kontakte me Shërbimin e Provës. Urdhërohet lirimi i tij nëse nuk mbahet për ndonjë vepër tjetër penale. Urdhërohet Prokuroria {...} për ekzekutimin e këtij vendimi.....*

7.9.3 Gjatë shqyrtimit të çështjes nga ana e magjistrates është administruar si provë dinamika e vuajtjes së dënimit me nr.ekstra prot., datë 24.01.2019 të paraqitur nga Institucioni i Ekzekutimit të Vendimeve Penale {...} . Sipas këtij akti rezulton se nga dënimi i dhënë, kërkuesi {...} ka kryer gjithsej 19 vjet, 5 muaj dhe 19 ditë, në të cilën janë përfshirë: (i) masa e dënimit të vuajtur fizikisht 11 vjet, 4 muaj dhe 20 ditë; (ii) koha e fituar me paraburgim sipas vendimeve gjyqësore përkatëse 4 vjet, 5 muaj dhe 8 ditë; (iii) uljet e dënimit të përfituara me vendimet respektive në masën prej 2 vjet e 3 muaj; (iv) masa e përfituar me aktivizim për punë kryer prej 4 muaj dhe 21 ditë; si dhe (v) periudha njëvjeçare e përfituar me amnisti sipas Ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, dhënë me vendimin nr. 463, datë 21.11.2018. Në këtë akt shkresor është shënuar se në masën e dënimit nuk ishte kryer zbritja e 90 ditëve ulje dënimi, të përfituara me vendimin nr.81, datë 18.01.2019, vendim i dhënë nga magjistratja {...} , për shkak se në datë 24.01.2019 ky vendim nuk kishte marrë ende formën e prerë. Nga aktet në dosje rezulton se ky vendim ka marrë formë të prerë pa u ankimuar nga palët, në datë 04.02.2019, para dhënies së vendimit përfundimtar me nr. 26 akti, datë 22.02.2019.

7.9.4 Magjistratja {...} në vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019 ka arsyetuar se duke ju referuar kësaj dinamike, i dënuari ka vuajtur gjithsej 19 vjet, 5 muaj dhe 19 ditë burgim, dhe i mbeten për të vuajtur 5 vjet, 6 muaj dhe 11 ditë burgim. Ndërkohë, që në dispozitivin e vendimit, nga ana e saj është vendosur lirimi me kusht i të dënuarit {...} për dënimin e mbetur të pavuajtur prej 5 vjet, 2 muaj dhe 11 ditë. Pra, rezulton se midis dinamikës së vuajtjes së dënimit të datës 24.01.2019 dhe dispozitivit të vendimit, të shpallur në datë 22.02.2019, rezulton një diferencë prej 4 muaj, e cila përkon me 3 muaj ulje dënimi të dhënë me vendimin nr. 81, datë 18.01.2019 dhe vijimësisë së vuajtjes së dënimit nga data 24.01.2019 deri në datën e shpalljes së vendimit 22.02.2019.

## **VI. Vlerësimet dhe Konkluzionet e Këshillit:**

37. Pavarësia e magjistratëve dhe e gjykatave është një element thelbësor i shtetit të së drejtës. Gjykata {...} <sup>28</sup> ka theksuar se parimi i pavarësisë, i deklaruar në disa dispozita të Kushtetutës, kërkon, në radhë të parë, që gjyqtarët dhe gjykatat ndërsa japin drejtësi, t'u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve<sup>29</sup>. Bazuar në parashikimet kushtetuese pushteti gjyqësor, përveç pavarësisë së jashtme (*pavarësia nga pushtetet e tjera*), ka edhe një pavarësi të brendshme (*gjyqtarët i nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve*)<sup>30</sup>.

<sup>28</sup> Shih vendimin nr. 5, datë 16.02.2012 të Gjykatës {...} .

<sup>29</sup> Neni 145, pika 1 e Kushtetutës – “1. Gjyqtarët janë të pavarur dhe u nënshtrohen vetëm Kushtetutës dhe ligjeve...”

<sup>30</sup> Shih vendimin nr. 40, datë 07.07.2014 të Gjykatës {...} .

38. Nga ana tjetër, në nenin 147, pika 1 të Kushtetutës parashikohet si organ kushtetues, Këshilli i Lartë Gjyqësor, i cili siguron jo vetëm pavarësinë dhe mbarëvajtjen e pushtetit gjyqësor, por dhe përgjegjshmërinë e tij. Në kuadër të kësaj fryme, Kushtetuta ka parashikuar se gjyqtari gëzon imunitet për mendimet e shprehura dhe vendimet e marra në ushtrimin e funksioneve të tij, por, ai nuk përjashtohet nga përgjegjësia në rastet e dhënies qëllimisht të një vendimi gjyqësor, si pasojë e një interesi vetjak ose keqbesimi.

39. Ndryshimet kushtetuese parashikojnë, përveç organeve të reja të qeverisjes së sistemit gjyqësor, krijimin e Inspektorit të Lartë i Drejtësisë, si organi kushtetues përgjegjës, për të hetuar shkeljet disiplinore të gjyqtarëve si dhe për inspektimin e gjykatave të të gjitha niveleve, brenda kufijve të të drejtave dhe procedurës së parashikuar në ligj. Dispozitat kushtetuese dhe ato ligjore përcaktojnë, pa asnjë dyshim, në mënyrë të ndarë fazat e procesit disiplinor ndaj gjyqtarëve, të cilat janë hetimi disiplinor, i cili realizohet nga Inspektori dhe procedimi disiplinor, i cili do të shqyrtohet dhe vendoset vetëm nga Këshilli, si një organ vendim-marrës kolektiv.

40. Neni 140 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon se gjyqtari mban përgjegjësi disiplinore, sipas ligjit. Në zbatim të këtij parashikimi kushtetues është miratuar ligji “Për Statusin”, i cili normon parimet e procedimit disiplinor, llojet e shkeljeve dhe të masave disiplinore që mund të caktohen ndaj magjistratit, si dhe procedurat hetimore dhe disiplinore që ndiqen ndaj tij nga Inspektori dhe Këshilli. Bazuar në këto dispozita kushtetuese dhe ligjore, Këshilli vlerëson se vendosja e një mase disiplinore ndaj një gjyqtari duhet të jepet gjithnjë dhe vetëm në kuadër të një procedimi disiplinor, të filluar nga organi kompetent, dhe të shqyrtuar sipas procedurave të parashikuara në ligjin “Për Statusin”, në funksion të garantimit të një procesi të rregullt ligjor dhe të parimeve të procedimit disiplinor si të parimit të ligjshmërisë, të akuzës, të barazisë para ligjit, të prezumimit të pafajësisë, të proporcionalitetit, etj.

41. Këshilli e ceku edhe më sipër se, Neni 102 i ligjit “Për Statusin” vendos shkeljet disiplinore në lidhje me ushtrimin e funksionit, por kjo dispozitë ligjore është shfuqizuar me vendimin nr. 34, datë 10.04.2017 të Gjykatës {...} . Më pas ky nen është plotësuar me ligjin nr.48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”<sup>31</sup>. Meqenëse shkeljet për të cilat kërkohet procedimi disiplinor i magjistrates {...} kanë ndodhur pasi Gjykata {...} ka shfuqizuar ndërmjet të tjerave edhe nenet 101-104 të ligjit “Për Statusin” dhe përpara se të hynte në fuqi ligji nr. 48/2019 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, për rrjedhojë këto dispozita ligjore nuk mund të zbatohen në rastin objekt shqyrtimi, prandaj çështja duhet të zgjidhet duke i referuar direkt nenit 140 pika 2 germa “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe dispozitave ligjore që ishin në fuqi në kohën e kryerjes së shkeljeve të pretenduara.

42. Në raportin e ILD thuhet se, në kuadër të procedimit disiplinor janë marrë për verifikim 17 vendime penale, me objekt lirim para kohe me kusht, 20 vendime me objekt ulje dënimi, sipas ligjit për trajtimin e të dënuarve me burgim dhe 17 vendime me objekt përfitim amnistie (faqe 8-

<sup>31</sup> Botuar në Fletoren Zyrtare nr.116, datë 6 Gusht 2019

9 e Raportit të ILD), por në përfundim të hetimit magjistratja {...} është sjellë përpara Këshillit për shkeljet disiplinore të mëposhtme:

43. Me vendimin nr. 65 akti, datë 06.11.2017, magjistratja në procedim ka vendosur:

- Pranimi i kërkesës.
- Aplikimin e dënimit alternativ “Qëndrim në shtëpi” për kërkuesin {...} , për pjesën e mbetur të dënimit prej 1 vit 8 muaj dhe 9 ditë burgim duke e vënë në provë për një periudhë kohore prej 1 vit dhe 8 muaj, etj.....

43. Sipas Inspektorit të Lartë të Drejtësisë ky vendim është marrë në kundërshtim me nenin 178 e vijues të Kodit të Procedurës Penale, pasi gjykata nuk ka kryer aktin e ekspertimit mjeko ligjor, e cila konsiderohet një provë vendimtare për zgjidhjen e çështjes. Në rastet kur kërkohet marrja e të dhënave që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore lejohet ekspertimi, konform nenit 178 e vijues të Kodit të Procedurës Penale. Në vendimin nr. 65 akti, datë 06.11.2017 Gjykata {...} nuk ka vendosur kryerjen e ekspertimit, por është mjaftuar vetëm me marrjen e mendimit të dy mjekëve të një spitali privat {...} .

45. Këshilli vlerëson se shqyrtimi faktit se, nëse një gjykatë nuk ka marrë një provë vendimtare ka të bëjë me mënyrën e zgjidhjes së çështjes, e cila është vetëm në kompetencën e një gjykate më të lartë, të cilës ligji i jep të drejtën që të shqyrtojë ankimin e bërë kundër vendimit të gjykatës së shkallës së parë. Neni 178/1 i Kodit të Procedurës Penale parashikon se: *Ekspertimi lejohet kur është i nevojshëm zhvillimi i kërkimeve ose marrja e të dhënave ose e vlerësimeve që kërkojnë njohuri të posaçme teknike, shkencore ose kulturore...*, pra sipas ligjit del e qartë që kryerja e ekspertimit nuk është i detyrueshëm për gjykatën, por në rastet kur kërkohen njohuri të posaçme, gjykata lejohet që të vendos kryerjen e tij, konkluzionet e të cilit mund të mos merren parasysh nga gjykata, me kusht që kjo e fundit të argumentojë qëndrimin e saj.

45.1 E parë në këtë këndvështrim del e qartë që është pikërisht gjykata që shqyrton ankimin, organi i vetëm kompetent që vlerëson se, nëse gjykata më e ulët e ka zbatuar ose jo ligjin procedural, kur është rasti për marrjen e një prove vendimtare, qoftë edhe me anë të ekspertimit. Ndërhyrja e Këshillit në këtë rast do të bënte që ai të shfaqte mendim për zgjidhjen në themel të një çështje gjyqësore, gjë e cila nuk është në natyrën e një organi administrativ, qoftë ai edhe me natyrë **quasi** gjyqësore. Në rastin në shqyrtim nga palët nuk është ushtruar e drejta e ankimit ndaj vendimit të Gjykatës {...} , prandaj për sa i përket çështjes së të dënuarit {...} , Këshilli arrin në përfundimin se përderisa nuk ekziston një vendim i një gjykate më të lartë, i cili të thotë që gjatë gjykimit, gjykata ka kryer shkelje të rënda të ligjit procedural ose material, të cilat mund të përbëjnë shkak për fillimin e procedimit disiplinor të gjyqtarit, pretendimin e ILD e gjen të pabazuar në kërkesat e nenit 140 pika 2 germa “a” i Kushtetutës, i cili parashikon se: *Gjyqtari shkarkohet nga Këshilli i Lartë Gjyqësor kur:*

a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarës gjatë ushtrimit të detyrës.....

46. Me vendimin nr. 85 akti, datë 25.05.2017 magjistratja ka vendosur:

- Pranimi i kërkesës të të dënuarit {...} .
- Uljen e dënimit në masën 24 muaj për periudhën nga data 14.10.2008- 25.05.2017.....

47. Me vendimin nr. 23 akti, datë 13.05.2014 Gjykata {...} ka vendosur: Njohjen e vendimit penal të huaj të {...} , dhënë ndaj shtetasit shqiptar {...} , i dënuar për veprat penale: vrasje, vrasje mbetur në tentativë dy herë, plagosje me dashje për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor, vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale “Vrasje në rrethana cilësuese” parashikuar nga neni 79/dh i Kodit Penal. Caktimin e dënimit me burgim të përjetshëm për shtetasin shqiptar {...} . Vuajtja e dënimit për të dënuarin të fillojë më datë 15.11.2007. Gjykata {...} me vendimin nr. 1239, datë 29.06.2015 ka vendosur: “Mospranim ankimi”, për shkak se është bërë nga persona të pa legjitimuar. Gjykata {...} me vendimin nr. 119, datë 28.01.2016 ka vendosur: “Mospranim rekursi”.

48. Në kohën kur kanë filluar procedurat e transferimit të të dënuarit, me vendimin nr. 382, datë 22.04.2016 të Gjykatës {...} është vendosur: Rivendosja në afat e kërkuesit {...} për të ushtruar ankim ndaj vendimit nr. 23, datë 13.05.2014”. Ky vendim është bërë objekt shqyrtimi së bashku me vendimin nr. 23, datë 13.05.2014 në përfundim të të cilit, Gjykata {...} me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 ka vendosur: Ndryshimin e vendimit nr. 23, akti datë 13.05.2014 të Gjykatës {...} , si vijon:

48.1 Pranimin e kërkesës. Njohjen e vendimit penal të huaj nr. T 20087287, datë 14.10.2008 të {...} , dhënë ndaj shtetasit shqiptar {...} , i dënuar për veprat penale: vrasje, vrasje mbetur në tentativë dy herë, plagosje me dashje për të shkaktuar lëndim të rëndë trupor, vepra penale të cilat korrespondojnë me veprën penale të “Vrasjes”, parashikuar nga neni 76 i Kodit Penal dhe caktimin e dënimit me 20 vite burgim, për veprën penale të “Vrasjes së mbetur në tentativë” dhe në bazë të nenit 76 dhe 23 të Kodit Penal caktimin e dënimit me 15 vite burgim, për veprën penale të “Plagosjes së rëndë me dashje” dhe në bazë të nenit 88/1 të Kodit Penal dënimin e tij me 10 vite burgim. Në bashkim të dënimeve, dënimin e të pandehurit {...} me 25 vite burgim. Vuajtja e dënimit fillon nga data 15.11.2007. Kundër këtij vendimi është ushtruar rekurs dhe çështja ndodhet për shqyrtim në Gjykatën {...} me nr. 59403-01652-00-2016, datë 16.09.2016, ndërsa ende nuk ka dalë me vendim mbi këtë çështje.

48.2 I dënuari {...} është transferuar në I.E.V.P {...} më datë 27.01.2016, referuar shkresës nr. 68/1 prot., datë 22.01.2016 të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sipas të cilës shtetasi {...} është marrë në dorëzim nga autoritetet angleze tek ato shqiptare dhe shoqërohet për në I.E.V.P {...} më datë 26.01.2016, ndërsa me vendimin nr. 278 akti, datë 10.10.2016 i është caktuar vendi i vuajtjes së dënimit në burg të sigurisë së zakonshme.

49. Me vendimin nr. 85 Akti, datë 25.05.2017 magjistratja ka vendosur uljen e dënimit të të dënuarit {...} , për një periudhë totale prej 24 muaj, nga momenti i dënimit të tij datë 14.10.2008 nga Gjykata {...} dhe deri në datën e dhënies së vendimit nr. 08, datë 25.05.2017 nga Gjykata e {...} .

50. Këshilli vlerëson se, në dhënien e këtij vendimi magjistratja ka shkelur rëndë kërkesat e ligjit nr. 8328/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar dhe në

kundërshtim me kërkesat e tij, ka aplikuar uljen e njëkohshme të dënimit për periudhën 14.10.2008-25.05.2017. Neni 63 të Ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, parashikon se: *Të dënuarit që zbatojnë rregullat dhe kanë një pjesëmarrje shembullore në veprimtaritë trajtuese, duke dhënë prova për ri integrim në shoqëri, mund të përfitojnë një ose disa ulje, deri 90 ditë në çdo vit të vuajtjes së dënimit. Në burgjet e sigurisë së lartë ulja e dënimit bëhet deri 45 ditë në vit. Për dhënien e këtij shpërblimi të veçantë, vlerësohet qëndrimi i të dënuarit nga ulja e mëparshme ose gjatë 12 muajve të fundit.* Në këtë dispozitë ligjore parashikohet se i dënuari që ka sjellje shembullore mund ta kërkojë këtë të drejtë një ose disa herë në vit dhe duhet vlerësuar sjellja nga ulja e fundit nëse ajo është më pak se 90 ditë në vit, ose kur nuk ka pasur ulje të mëparshme vlerësohet sjellja e të dënuarit gjatë 12 muajve të fundit.

51. Me këtë vendim, Gjykata {...} ka disponuar jo vetëm për uljen në total të dënimit në masën 90 ditë për çdo vit kalendarik, por ajo ka disponuar edhe për një periudhë kohore të dënimit të vuajtur nga i dënuari {...} në shtetin e huaj, para kohës së ekzekutimit të vendimit të njohjes në shtetin shqiptar, pra nga data 14.10.2008 deri më datë 27.01.2016, duke mos pasur asnjë lloj vlerësimi dhe shkelur në mënyrë flagrante edhe Konventën e Këshillit të Europës për transferimin e të dënuarve me burgim, e ratifikuar me ligjin nr. 8499/1999.

51.1 Këshilli vlerëson që i dënuari {...} mund të bënte kërkesë për ulje dënimi vetëm për periudhën e dënimit të kryer pas datës 26.01.2016, ditë kur ai është vendosur në IEVP {...} , duke plotësuar në mënyrë kumulative të gjitha kërkesat e parashikuara nga ligji nr.8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, të cilin magjistratja {...} e ka injoruar në mënyrë të hapur. I ndodhur në këto rrethana Këshilli, e gjen të bazuar në nenin 140/2/a të Kushtetutës këtë kërkim të ILD, pasi shkelja e kryer nga magjistratja përbën një shkelje të rëndë profesionale që diskrediton pozitën dhe figurën e magjistratit gjatë ushtrimit të detyrës.

52. Me vendimin nr. 82 akti, datë 14.02.2018 magjistratja ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës të të dënuarit {...} .
- Njohjen e ditëve të paraburgimit të të dënuarit nga data e arrestimit të tij nga autoritetet angleze datë 15.11.2007 deri kur vendimi i Gjykatës {...} ka marrë formë të prerë më datë 20.07.2016.....

53. Në urdhrin e ekzekutimit të prokurorit të datës 07.09.2016 rezulton se është kryer përlllogaritja e kohës së paraburgimit sipas nenit 57 të Kodit Penal, dhe ajo e dënimit me burgim të vuajtur nga i dënuari në shtetin e huaj, duke përcaktuar se nga dita e transferimit në Shqipëri datë 26.01.2016 e në vazhdim i mbeteshin për të kryer edhe 16 vjet 4 muaj dhe 3 ditë burgim. Ky urdher ekzekutimi ndodhet në dosjen me nr. 82 akti, datë vendimi 14.02.2018 të administruar nga magjistratja {...} .

54. Pavarësisht përlllogaritjes së kohës së paraburgimit të kryer nga prokurori i ekzekutimit, magjistratja në procedim i ka rinjohur të dënuarit {...} kohën e burgimit në shtetin e huaj si kohë

paraburgimi deri në dhënien e vendimit të njohjes së vendimit të huaj nga gjykatat shqiptare, në kundërshtim me parashikimet e nenit 57 të Kodit Penal; neneve 438, 518, pika 1 dhe nenit 3, të Kodit të Procedurës Penale, nenit 9, pika 3, të Ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”; nenit 52, paragrafi 2, të Ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe vendimit unifikues nr.154/2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, duke sjellë përfitim të padrejtë për të dënuarin {...} .

55. Kjo shkelje disiplinore është pranuar gjatë procedimit disiplinor edhe nga përfaqësuesi i magjistrates, Av. {...} , por ai ka pretenduar se shkelja nuk përbën një shkelje të rëndë disiplinore të magjistratit gjatë kryerjes së detyrës, duke i kërkuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë bërjen e një marrëveshje të përbashkët pranimit, në përputhje me kërkesat e nenit 135 të ligjit “Për statusin”, i ndryshuar, gjë e cila nuk u pranua nga ky i fundit.

56. Këshilli vlerëson se, shkelja që ka bërë magjistratja në këtë rast është një shkelje shumë e rëndë gjatë kryerjes së detyrës, pasi sipas Konventës së Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”, përllogaritja e paraburgimit bëhet sipas ligjit të vendit pritës, pra sipas ligjit shqiptar, duke e përllogaritur me një ditë e gjysmë kohën nga arrestimi/ndalimi i të pandehurit dhe deri sa vendimi i Gjykatës {...} ka marrë formë të prerë, gjë të cilën e ka bërë organi i prokurorisë shqiptare në momentin që i dënuari ka ardhur në territorin e Republikës së Shqipërisë.

57. Në dhënien e këtij vendimi, Gjykata {...} ka llogaritur si kohë paraburgimi edhe kohën kur shtetasi shqiptar {...} ka qenë i dënuar me vendim të formës prerë nga gjykata {...} dhe deri në kohën e dhënies së vendimit nga gjykata shqiptare e apelit, duke bërë që me anë të vendimeve nr. 85 akti, datë 25.05.2017 dhe nr. 82 akti, datë 14.02.2018, për të njëjtën periudhë kohe, magjistratja i ka njohur kërkuesit dy cilësi: cilësinë e të paraburgosurit dhe cilësinë e të dënuarit, duke sjellë për të përfitime të padrejta.

57.1 Duhet të sqarohet se, kur njihet një vendim i një gjykate të huaj në vendin tonë, gjykata shqiptare nuk ka të drejtë që të disponojë mbi atë që ka vendosur gjykata e huaj, por vetëm pasi kontrollon kriteret ligjore të njohjes e përshtat masën e dënimit që ka dhënë gjykata e huaj me dënimin korrespondues që parashikon ligji shqiptar dhe jo siç ka vepruar magjistratja {...} në këtë rast kur konsideron se, vendimi penal për të dënuarin {...} ka marrë formë të prerë kur ka vendosur Gjykata {...} me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016, veprim i cili është krejtësisht abuziv, pasi ky vendim ka marrë formë të prerë me datë 14.10.2008 kur ai vuante dënimin me burgim {...} .

58. Me vendimin nr. 81 datë 18.01.2019 magjistratja ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës.
- Uljen e dënimit për kërkuesin {...} në masën 90 ditë për periudhën kohore, vitin 2007...

59. Me vendimin nr. 1016, datë 20.07.2016 të Gjykatës {...} është përcaktuar koha e fillimit të vuajtjes së dënimit nga data 15.11.2007. Ndërkohë konstatohet se me vendimin nr. 81, datë 18.01.2019 magjistratja nën hetim disiplinor {...} , në kundërshtim me disponimin e vendimit të

Gjykatës {...} i ka ulur dënimin të dënuarit në masën 90 ditë në vitin 2007, duke shkelur kërkesat e nenit 63 të Ligjit nr. 8328/1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, i ndryshuar.

60. Ky disponim i magjistrates jo vetëm që është në kundërshtim me parashikimet e ligjit që cituam më sipër, por edhe me parashikimet e 57 të Kodit Penal; neneve 438, 518, pika 1 dhe nenit 3 të Kodit të Procedurës Penale; nenit 9, pika 3, të Ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”; nenit 52, paragrafi 2 i ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” dhe vendimit unifikues nr. 154/2000 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë.

61. I dënuari {...} ka qenë i paraburgosur nga data 15.11.2007 deri me datë 14.10.2008 kohë kur vendimi penal i huaj ka marrë formë të prerë, dhe cilësinë e të dënuarit ai e ka marrë nga data 14.10.2008 dhe në vijim, ndërkohë që ulja e dënimit është bërë për një periudhë kur ai nuk ka qenë i paraburgosur, ose nuk ka patur cilësinë e të dënuarit, por atë të pandehurit, çka do ta bënte këtë veprim të magjistrates një veprim në kundërshtim të hapur me kërkesat e ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, i ndryshuar, duke sjellë për rrjedhojë përfitime të pa drejta për të dënuarin {...} .

62. Me vendimin nr. 463 akti datë 21.11.2018, magjistratja ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkuesit {...} .
- Njohjen e amnistisë për kërkuesin {...} , duke i ulur 1 vit nga dënimi, sipas ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”.....

63. Veprat penale të parashikuara nga legjislacioni penal shqiptar për të cilat kërkuesi {...} është dënuar: “Vrasje me dashje”, “Vrasje me dashje e mbetur në tentativë” dhe “Plagosje e rëndë me dashje” të parashikuara nga nenet 76, 76-23 dhe 88/1 të Kodit Penal, kategorizohen si ndaluese për përfitim amnistie referuar kriterit ndalues të parashikuar në nenin 4/b dhe 4/c të ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”, sipas të cilit: *Pavarësisht nga përcaktimet e nenit 3, nuk përfitojnë nga kjo amnisti personat e dënuar për: b) krime kundër jetës, të kryera me dashje të parashikuara në nenet 76..... c) vepra penale të kryera me dashje kundër shëndetit të parashikuara nga nenet ....88 ..... të Kodit Penal.*

64. Vendimi nr. 463 akti, datë 21.11.2018 i Gjykatës {...} është dhënë në shkelje të parashikimeve të nenit 5 të ligjit nr.141/2016 “Për amnistinë”, i cili parashikon shprehimisht se: *Të gjithë personat e dënuar, të cilët nuk përfitojnë nga parashikimi i nenit 3 të këtij ligji, pavarësisht nga kriteret ndaluese të nenit 4, lirohen nëse u kanë mbetur pa vuajtur nga dënimi i dhënë: b) deri në 1 vit për personat e dënuar burra.*

65. Nga dokumentacioni i verifikuar del qartë se, në kohën e amnistisë i dënuari {...} ka patur më shumë se një vit nga dënimi i pavuajtur, prandaj nuk gjen zbatim parashikimi i nenit 5 të ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë”. Por duhet thënë që ligji që cituam megjithëse ka kriteret ndaluese për veprat penale, për të cilat është dënuar kërkuesi {...} , në nenin 5 të tij ai i jep kësaj kategorie të dënuarish të drejtën se, kur ato kanë deri në një vit burgim, duhet të lirohen nga burgu. Pra, vetë ligji i amnistisë nuk është kategorikisht ndalues për personat e dënuar për vepra



penale të tilla, por përfitimin e tyre nga amnistia e lidh me kohën e pavuajtur të dënimit, gjë e cila që e ul edhe rëndësinë e shkeljes disiplinore të bërë nga magjistratja, përsa i përket kësaj çështje.

66. Me vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019 magjistratja ka vendosur:

- Pranimin e kërkesës së kërkuesit (të dënuarit) {...} .
- Lirimin me kusht të kërkuesit (të dënuarit) {...} për dënimin e mbetur të pavuajtur prej 5 vjet, 2 muaj dhe 11 ditë, për një kohë prove prej 5 vjetësh, etj.....

67. Ky vendim është marrë në shkelje të rëndë të nenit 64 paragrafi 1 ndarja e tretë e Kodit Penal për shkak të mosplotësisimit të kushtit për të përfituar lirim para kohe me kusht, ai i periudhës efektive të dënimit të vuajtur nga i dënuari {...} prej  $\frac{3}{4}$  si dhe, shkeljen e kriterit ndalues të parashikuar nga neni 64 paragrafi 2 i Kodit Penal i cili parashikon se: Në masën e dënimit të vuajtur nuk llogaritet koha e përfituar me amnisti ose me falje.

68. Duhet vënë në dukje se edhe kjo shkelje është pranuar gjatë procedimit disiplinor nga mbrojtësi i magjistrates, duke kërkuar marrëveshje me ILD. Nga dinamika e vuajtjes së dënimit me nr. ekstra prot., datë 24.01.2019 të ndodhur në dosje rezulton se i dënuari {...} me vendimin e Gjykatës {...} nr. 1016, datë 20.07.2016 është dënuar me 25 vjet burgim për kryerjen e veprave penale të parashikuara nga nenet 76, 76-23 dhe 88/1 të Kodit Penal.

69. Magjistratja në procedim {...} në vendim ka arsyetuar se, duke iu referuar kësaj dinamike, i dënuari ka vuajtur gjithsej 19 vjet, 5 muaj dhe 19 ditë burgim, dhe i mbeten për të vuajtur 5 vjet 6 muaj dhe 11 ditë burgim. Konstatohet se  $\frac{3}{4}$  e dënimit prej 25 vite burgim për këtë kategori të dënuarish, rezulton të jetë 18 vjet dhe 9 muaj, ndërsa  $\frac{1}{4}$  rezulton të jetë 6 vjet dhe 3 muaj.

70. I dënuari {...} me vendimin nr. akti 463, datë 21.11.2018, të dhënë po nga magjistratja {...} ka përfituar 1 vit ulje me amnisti sipas ligjit nr. 141/2016 “Për dhënie amnistie”, e cila i është llogaritur të dënuarit në dinamikën e vuajtjes së dënimit të datës 24.01.2019, të cilës i është referuar magjistratja në përlllogaritjen e kohës së vuajtjes së dënimit. Pra rezulton se në vuajtjen e dënimit gjyqtarja i ka llogaritur edhe kohën e përfituar me amnisti në shkelje të hapur me parashikimet e bëra nga neni 64/2 i Kodit Penal.

71. Gjithashtu në marrjen e këtij vendimi nga magjistratja nuk është zbatuar parashikimi i nenit 64 të Kodit Penal mbi arsyet e veçanta për të përfituar nga instituti i lirimimit me kusht, veprim ky që bie në kundërshtim me vendimin unifikues nr. 02/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës {...} . Për rrjedhojë moszbatimi i këtij vendimi unifikues ka sjellë edhe mosrespektim të legjislacionit procedural penal mbi detyrimin e gjykatave për zbatim të vendimeve unifikuese të Gjykatës {...}

, konkretisht nenit 438/a të Kodit të Procedurës Penale. Referuar këtij vendimi unifikues në shqyrtimin e kërkesës gjykata nuk ka vlerësuar ato çështje të përcaktuara në këtë vendim sikundër janë: natyra e veprës penale të kryer, qëndrimi i të dënuarit ndaj veprës penale, si dhe pendimi i të dënuarit bazuar në të dhëna objektive, ndonjë vepër penale e mëparshme e kryer nga i dënuari, dinamika e sjelljes së të dënuarit, apo raporti i autoriteteve të I.E.V.P-së.

72. Edhe më parë, Këshilli ka mbajtur qëndrimin se, të gjitha rrethanat e parashikuara nga ligji në paragrafin e dytë të nenit 65 të Kodit Penal, duhet të përmbushen në mënyrë kumulative (të njëkohshme), jo vetëm sepse ligjvënësi ka përdorur lidhësen bashkuese “dhe”, por edhe sepse plotësimi i të tre kushteve (vuajtja jo më pak se  $\frac{3}{4}$  e dënimit me burgim, sjellja shembullore gjatë gjithë kësaj periudhe, arritja e qëllimit të dënimit-rehabilitimi dhe edukimin e tij- ri integrimi) do të justifikonin edhe ekzistencën e rastit të jashtëzakonshëm që kërkohet për mundësinë e lirit të të dënuarit {...} , i cili fillimisht është dënuar me burgim të përjetshëm, dhe pas njohjes së vendimit nga gjykata shqiptare, dënimi i tij u konvertua me 25 vjet burgim.

73. Në vendimin nr. 26 akti, datë 22.02.2019, me objekt lirim para kohe me kusht, magjistratja {...} nuk ka mbajtur parasysh asnjë kërkesë të parashikuar nga neni 64 i Kodit Penal, i cili në mënyrë urdhëruese ndalon përfshirjen e kohës së përfituar me amnisti në përlogaritjen e dënimit për të përfituar nga instituti i lirit me kusht. Gjithashtu, ajo ka injoruar edhe vendimin unifikues nr.02/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë në lidhje me arsyen e veçantë që një këtë rast nuk ekziston. Rehabilitimi i të dënuarit nuk lidhet vetëm me mungesën e masave disiplinore për një periudhë kohe kaq të shkurtër, por sjellja e tij duhet të jetë shembullore që nga dita që vendimi penal merr formë të prerë dhe deri në kohën kur gjykata disponon me vendim për kërkesën me objekt lirim para kohe me kusht. Neni 64 i Kodit Penal përmend fjalën “mund” që do të thotë që ky institut i të drejtës penale nuk është i zakonshëm, ku çdo i dënuar që bën një kërkesë të tillë mund të lirohet. Ky është një “benefit” që e përfitojnë vetëm të dënuarit shembullor, që ndjehen thellësisht të penduar për veprat penale të kryera, sigurisht duke përmbushur në të njëjtën kohë edhe kërkesat e tjera të ligjit.

74. Për sa thamë më sipër, Këshilli arrin në përfundimin se, veprimet/mosveprimet e kryera nga ana e magjistrates {...} në dhënien e vendimit nr. 26 akti, datë 22.02.2019, me objekt lirim para kohe me kusht të të dënuarit {...} konstatohen shkelje shumë të rënda të ligjit material penal në moszbatimin e kërkesave të parashikuara nga Neni 64 i Kodit Penal për mos llogaritjen e amnistisë dhe mos zbatimin e detyrueshëm të vendimit unifikues nr. 02/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës {...} .

75. Së fundmi konstatohet se, asnjëri prej vendimeve të dhëna për të dënuarin {...} nga magjistratja {...} nuk janë arsyetuar, konform kërkesave të nenit 383 të Kodit të Procedurës Penale, si dhe standardeve të arsyetimit të vendimit gjyqësor, të vendosura nga Gjykata {...} në jurisprudencën e saj të krijuar në vite. Arsyetimi i vendimeve gjyqësore nuk është fakultativ, por është një detyrim për gjykatën, i cili rrjedh nga parashikimi i nenit 142/1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili parashikon shprehimisht se: *Vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara*. Ky detyrim kushtetues përbën garanci për zhvillimin nga ana e gjykatës të një procesi të rregullt ligjor. Nga ana tjetër edhe Gjykata Evropiane e të Drejtave të Njeriut i jep rëndësi të veçantë arsyetimit të vendimit gjyqësor, duke thënë se kjo gjë tregon qartë që palët në proces janë dëgjuar nga gjykata. Gjithashtu duhet thënë se një vendim i arsyetuar në përputhje me ligjin i jep mundësi gjykatës më të lartë, e cila bën kontrollin e vendimit që të vlerësojë saktë qëndrimin e mbajtur nga gjykata më e ulët. Përveç këtyre që thamë edhe neni 6 i KEDNJ, si edhe Rekomandimi i Komitetit të Ministrave të Këshillit të Europës drejtuar shteteve anëtare mbajnë qëndrimin që vendimet gjyqësore duhet të jenë të arsyetuara, të kuptueshme dhe të qarta,

detyrime, këto që magjistratja {...} nuk i ka zbatuar gjatë arsytimit të vendimeve që cituam më sipër, të cilat i përkasin të dënuarit {...} .

76. Në nenin 115, pika 1, të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar parashikohen në mënyrë jo shteruese, si kritere për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore: (a) lloji dhe rrethanat e shkeljes; (b) shkalla e fajësisë dhe motivi; (c) pasojat e shkeljes; (ç) të dhënat profesionale, të çështjeve disiplinore dhe të dhëna kriminale të magjistratit; (d) masën e ndonjë rreziku të shkaktuar nga shkelja disiplinore; (dh) çdo rrethanë e rëndësishme që ka lidhje me shkeljen; (e) rrethana të lidhura me gjendjen shëndetësore të magjistratit; (ë) sjellja e magjistratit pas kryerjes së shkeljes dhe pas fillimit të hetimit; (f) sjellja e magjistratit gjatë procedimit hetimit/procedimit disiplinor dhe qëndrimin që mban ndaj tij; (g) çdo çështje tjetër që konsiderohet e rëndësishme.

77. Duke analizuar rrethanat e shkeljeve disiplinore rezulton se: nga ana e magjistrates {...} janë ndërmarrë veprime/mosveprime të cilat kanë të bëjmë me mosrespektim të rëndë dhe të vazhduar të legjislacionit material dhe procedural penal, duke mos respektuar parashikimet e nenit 57 të Kodit Penal; neneve 438, 518, pika 1 dhe nenit 3 të Kodit të Procedurës Penale; nenit 9, pika 3 të Ligjit nr. 8499, datë 10.6.1999 “Për ratifikimin e Konventës së Këshillit të Europës “Për transferimin e personave të dënuar”; nenit 52, paragrafi 2, të ligjit nr. 8331 datë 21.04.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale”, vendimet unifikuese nr. 154/2000 dhe nr. 02/2015 të Kolegjeve të Bashkuara të Gjykatës së Lartë, ligjit nr. 141/2016 “Për amnistinë” dhe nenet 64 e 65 të Kodit Penal, pra nuk janë respektuar dispozita penale me karakter urdhërues, të cilat parashikojnë kritere me karakter objektiv, ndalues dhe me një përmbajtje të drejtpërdrejtë dhe lehtësisht të kuptueshme ku përvoja e gjatë profesionale në detyrë e magjistrates e lejon të interpretojë dhe zbatojë drejtë këto dispozita ligjore. Këto veprime/mosveprime nga magjistratja {...} janë kryer në mënyrë drejtpërdrejtë, të vazhduar, të vullnetshme dhe të pajustificuar në disa procese gjyqësore të zhvilluara ndaj të dënuarit {...} brenda një harku kohor të shkurtër për ti krijuar atij mundësinë që të lirohet sa më shpejt nga burgu, megjithëse ka qenë i dënuar për vepra shumë të rënda penale.

78. Ushtrimi i pa rregullt të detyrës nga ana e magjistrates {...} ka sjellë pasojat për dhënien e drejtësisë, cenimin e besimit ndaj saj dhe tek drejtësia në përgjithësi në një moment kur çdo gjyqtar i sistemit të drejtësisë duhet të bëjë të kundërtën, duke përmbushur në mënyrë sa më të rregullt detyrën e ngarkuar në mënyrë që ti kthejmë publikut besimin e humbur tek drejtësia, e cila është një proces reformimi. Duhet theksuar se sjellja e magjistratëve në kontekstin profesional është shumë e rëndësishme. Duke iu referuar parimeve të Bangalores, cenimi edhe vetëm i parimeve të etikës, në marrëdhëniet e punës apo edhe jashtë saj mund të përbëjë shkak për cenimin e besimit të publikut tek sistemi i drejtësisë. Referuar “teorisë së dukjes”, drejtësia jo vetëm duhet të bëhet por edhe duhet të shihet. Në këtë kuptim, sjellje të caktuara të gjyqtarës konsiderohen si cenim i parimit të besimit të publikut tek drejtësia.

79. Duhet thënë që lirimet e pamërituara me kusht të personave që kanë kryer vepra shumë të rënda penale dhe që kanë rrezikshmëri të lartë shoqërore ndikojnë shumë në ndjeshmërinë e publikut, duke u bërë shtrat edhe për kultivimin e ndjenjës së hakmarrjes dhe vetëgjyqësisë, sipas

parimit të talonit. Situata bëhet edhe më e rëndë po të kemi parasysh se këto vepra penale janë kryer në një vend evropian, i cili duke u bazuar në marrëveshjet e ratifikuara ndërkombëtare i ka besuar vendit tonë që shtetasi i tij të vuaj pjesën e mbetur të dënimit pranë familjes së tij në Shqipëri. Transferimi nuk ka për qëllim që të dënuarit t'i krijohet terreni i duhur që ai të lirohet para kohe me kusht pa përmbushur asnjë kriter ligjor. Vendimmarrjet e magjistrates në procedim janë të tilla që e cenojnë rëndë figurën e një magjistrati si brenda vendit, ashtu edhe tek autoritetet gjyqësore të Mbretërisë së Bashkuar dhe më gjerë.

80. Në rastet kur shkeljet disiplinore të kryera janë aq të rënda, sa e bëjnë të papërshtatshme apo të padenjë magjistraten për të vazhduar funksionin e saj, atëherë masa disiplinore nuk mund të luajë më rol edukues ndaj saj. Në këtë rast, masa disiplinore merr përsipër të mbrojë interesin publik, duke larguar nga detyra magjistraten dhe duke u kthyer kështu në masë me natyrë të pastër ndëshkuese ndaj saj. Kjo masë disiplinore parashikohet shprehimisht në nenin 140, pika 2 germa “a” të Kushtetutës, sipas të cilit gjyqtari shkarkohet nga detyra kur: a) kryen shkelje të rënda profesionale ose etike që diskreditojnë pozitën dhe figurën e tij gjatë ushtrimit të detyrës.....Në të njëjtën kohë kjo masë ndëshkimore parashikohet edhe në nenin 111 të Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, ku parashikohet përgjegjësia disiplinore e magjistratit për një shkelje shumë të rëndë, që e bën atë të papërshtatshëm ose të padenjë për të vazhduar ushtrimin e funksionit.

81. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, i cili ka dalë në bazë dhe në zbatim të nenit 140 të Kushtetutës, ka përcaktuar se cilat veprime/mosveprime të magjistratëve përbëjnë shkelje disiplinore, që përbëjnë shkak për marrjen e masës disiplinore ndaj gjyqtarës. Në të njëjtën kohë, në ligj nuk parashikohen në mënyrë të drejtpërdrejt se cilat shkelje disiplinore janë të lehta, të rënda apo shumë të rënda, por për të arritur në këtë konkluzion në lidhje me rëndësinë e shkeljes disiplinore duhet të bëhet rast pas rasti një analizë juridike dhe faktike e kriterëve për caktimin e rëndësisë së shkeljes disiplinore të parashikuara nga neni 115 i Ligjit nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, në raport me faktet e provuara në këtë proces disiplinor. Ligji nr. 96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”, parashikon se për shkelje shumë të rënda disiplinore mund të jepet masa disiplinore “Pezullimi si masë disiplinore” apo “Shkarkimi”. Të dyja këto masa mund të jepen për shkelje shumë të rënda, por vetëm me dallimin lidhur me papërshtatshmërinë apo padenjësinë e magjistratit për të vazhduar funksionin e tij, si pasojë e kryerjes së një shkelje disiplinore që diskrediton pozitën dhe figurën e gjyqtarës gjatë ushtrimit të detyrës.

82. Në këto kushte, në rastin konkret duhet të analizohet fakti nëse veprimet/mosveprimet e ndërmarra nga ana e magjistrates {...} që përbëjnë “Shkelje shumë të rënda disiplinore” përbëjnë “akte që diskreditojnë pozitën dhe figurën e gjyqtarës” gjatë ushtrimit të detyrës” dhe për rrjedhojë e bëjnë atë të pa përshtatshme apo të padenjë për të vazhduar funksionin e saj si magjistrate. Veprimet apo mosveprimet e gjyqtarës që analizohen në bazë të rrethanave të

kryerjes së tyre, momenti subjektiv si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve nga magjistratja.[<sup>32</sup>]

83. Koncepti i shkeljeve të rënda profesionale që diskreditojnë rëndë pozitën dhe figurën e gjyqtares nuk është një koncept i ri në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë. Madje, ky koncept është pasuruar edhe nga jurisprudenca konstante e Gjykatës {...}, e cila ka vënë në dukje se:.....*kjo shprehje, përmbledh në vetvete një sërë elementësh, të cilët mund të identifikohen rast pas rasti nga organi përkatës që merr vendimin për shkarkimin e gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, të Gjykatës {...} . Më tej, Gjykata {...} vazhdon me arsyetimin se ato janë të lidhura me akte e sjellje të parregullta e të padenja që këta funksionarë të lartë kryejnë gjatë ushtrimit të detyrës, për shkak të saj si dhe jashtë detyrës. Këto veprime apo mosveprime që analizohen në bazë të rrethanave të kryerjes së tyre, momenti subjektiv si dhe dëmet që i sjellin shoqërisë dhe shtetit duhet të jenë të asaj natyre që e bëjnë të pamundur kryerjen e mëtejshme të funksioneve kushtetuese nga këto subjekte [<sup>33</sup>]* Referuar parashikimeve të trajtuara më sipër kuptohet dhe del qartë rëndësia e madhe që ka respektimi i normave ligjore nga ana e gjyqtares gjatë ushtrimit të detyrës së tij. Kjo rëndësi del qartë dhe nga fakti se pikërisht shkeljet e pajustificuara dhe të vazhduara të këtyre normave, kur kanë sjellë ose mund të sjellin pasoja për të drejtat kushtetuese të palëve ose për dhënien e drejtësisë konsiderohen si akte dhe sjellje që diskreditojnë rëndë figurën e magjistratit siç është rasti i gjyqtares {...} , e cila nuk është e denjë për të mbajtur më tej funksionin e gjyqtares pranë Gjykatës {...} .

84. Nga sa më lart dhe përfundimisht, Këshilli arrin në përfundimin se kërkesa e paraqitur nga Inspektori i Lartë i Drejtësisë është e bazuar në ligj dhe në prova dhe se ndaj magjistrates {...} duhet të vendoset masa disiplinore e “*Shkarkimit nga detyra*”, bazuar në nenin 140, pika 2, shkronja “a” të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe në nenin 111 të ligjit “*Për Statusin*”.

85. Sipas nenit 157 pika 2 të ligjit “*Për Statusin*” parashikohet se: “2. Nëse magjistrati dënohet për kryerjen e një vepre penale nga gjykata e shkallës së parë ose jepet masë disiplinore për një shkelje disiplinore nga Këshilli kompetent, Këshilli mund të pezullojë përfitimin e pagës deri në 50 për qind, si dhe përfitimet e tjera të magjistratit, derisa të vendoset mbi çdo ankim të paraqitur në gjykatën më të lartë....” Bazuar në këtë parashikim ligjor dhe nisur nga lloji i masës disiplinore të caktuar ndaj magjistrates, Këshilli çmon të pezullojë përfitimin e pagës në masën 50% si dhe përfitimet e tjera të saj, derisa ky vendim të marrë formë të prerë.

86. Në lidhje me të drejtën e ankimit, Këshilli vëren se neni 147 i ligjit “*Për Statusin*” përcakton të drejtën e ankimit ndaj vendimeve disiplinore. Sipas këtij neni, magjistrati dhe Inspektori kanë të drejtë të ankimojnë vendimin për masë disiplinore në gjykatën kompetente. Ndërkohë, neni 140 i Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë parashikon shprehimisht se: “...4. *Kundër vendimit të shkarkimit mund të bëhet ankim në Gjykatën {...}* ” Një dispozitë e veçantë për ankimet është vendosur dhe në ligjin nr.115/2016, “*Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë*”, konkretisht në nenin 100, në të cilin parashikohet se: “1. *Ndaj aktit administrativ*

[<sup>32</sup>] Vendimi Nr. 75/2002, i Gjykatës {...} ; Vendimi Nr. 3/2006 i Gjykatës {...} .

[<sup>33</sup>] Shih për më tepër vendimin 11/2004.

*individual të Këshillit mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit, përveçse kur parashikohet ndryshe në këtë ligj. Aktet administrative individuale që vendosin masa disiplinore mbi gjyqtarët ankimohen në Gjykatën Kushtetuese... .”*

87. Në vijim të procesit të ankimit, neni 179, pika 7 e Kushtetutës parashikon shprehimisht se “...7. Gjatë mandatit të tyre nëntëvjeçar gjyqtarët e Kolegjit të Apelimit, sipas nenit 179/b, kanë juridiksion disiplinor ndaj gjyqtarëve të Gjykatës Kushtetuese, anëtarëve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, anëtarëve të Këshillit të Lartë të Prokurorisë, Prokurorit të Përgjithshëm dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Kolegji i Apelimit shqyrton ankimet ndaj vendimeve të Këshillit të Lartë Gjyqësor, Këshillit të Lartë të Prokurorisë dhe Inspektorit të Lartë të Drejtësisë për vendosjen e masave disiplinore, përkatësisht ndaj gjyqtarëve, prokurorëve dhe inspektorëve të tjerë... .” Duke parë edhe qëndrimin e fundit që ka mbajtur Gjykata { ... } në rastin e ankimit të magjistratit { ... } <sup>34</sup>, Këshilli vlerëson të shprehet në dispozitivin e vendimit se, ky i fundit mund të ankimohet nga palët në { ... } , pranë Gjykatës { ... } .

### **PËR KËTO ARSYE:**

Këshilli { ... }, duke u bazuar në nenet 140, pika 2, shkronja “a”, 147, pika 1 dhe 147/a, pika 1, shkronja “b”, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, nenet 86, shkronja “e” dhe 97, pika 1, shkronja “a” dhe pika 3, të Ligjit nr.115/2016, “Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë”, i ndryshuar, si dhe në nenin 104, të Kodit të Procedurave Administrative të Republikës së Shqipërisë;

### **VENDOSI:**

1. Pranimin e kërkesës së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë.
2. Shkarkimin nga detyra të magjistrates { ... } , me detyrë gjyqtare në Gjykatën { ... } Pezullimin e përfitimit të pagës në masën 50% si dhe përfitimet e tjera të magjistrates { ... } , deri kur ky vendim të marrë formë të prerë.
3. Kundër këtij vendimi lejohet ankim sipas ligjit në { ... } , pranë Gjykatës { ... }, afati i të cilit fillon nga e nesërmja e njoftimit të arsyetimit të këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

### **PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR**

**Kryetare**  
**NAUREDA LLAGAMI**

**Zëvendëskryetar**  
**MAKSIM QOKU**

**Anëtar**  
**MEDI BICI**

**Anëtar**  
**ILIR TOSKA**

---

<sup>34</sup> Vendimi nr.35, datë 26.02.2021 i Gjykatës { ... }

**Anëtare**  
**BRIKENA UKPERAJ**

**Anëtare**  
**FATMIRA LULI**

**Anëtare**  
**MARÇELA SHEHU**

**Anëtar**  
**ERJON MUHARREMAJ**

**Anëtar**  
**ALBAN TORO**

**Anëtar**  
**DRITAN HALLUNAJ**